



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PËRMIRËSIMIT TË
KLIMËS SË BIZNESIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2020

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

Rruga _____, Tiranë

e.mail: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të datës 13.07.2020, drejtuar me e.mail Bashkisë Shkodër dhe regjistruar me nr.9950 prot., datë 14.07.2020, ju informojmë se:

Në territorin e Bashkisë Shkodër, gjatë kësaj periudhe janë duke u kryer pune publike.

Më poshtë do të keni, listen e punimeve publike të kryera apo në proces gjatë këtij viti.

Nr.	Objekti i prokurimit	Faza	Shënime
1	Sistemim asfaltim rrugë të brendshme fshati Gomsiqe	Njoftim fituesi, ne pritje për te lidhur kontraten	Punë
2	Sistemim asfaltim rruga “Myzyraj” Loti II	Njoftim fituesi, në pritje për të lidhur kontraten	Punë
3	Sistemim asfaltim rruga e varrezave Bleran	Njoftim fituesi, në pritje për të lidhur kontraten	Punë
4	Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social. (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontenier 1 + 1 dhe 2 + 1)”	Në proces zbatimi të kontratës	Punë
5	Rikualifikim urban i sheshit ne fshatin Zogaj	Realizuar investimi	Punë
6	Ndërtim parcela te reja varrezash	Realizuar investimi	Punë
7	Investime ndriçimi rrugë kryesore	Realizuar investimi	Punë
8	Zëvendësimi shtyllash zinkat, ndriçuesve të dëmtuar zinkat dhe i kapakëve të shtyllave	Në proces zbatimi të kontratës	Punë

9	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore (Rrethimi)	Njoftim fituesi, në pritje për tu lidhur kontrata me operatorin ekonomik fitues	Shërbim
10	Mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore (bojatisja)	Proces vlerësimi	Shërbim
11	Loti II-te: "Riparim të Shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në Njësitë Administrative"	Njoftim fituesi, në pritje për të lidhur kontraten	Shërbim
12	Loti-I-rë: "Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje në segmentin "Ura e Mesit-Prekal-Kir-Breglumi-Ndërlisaj-Thethe"	Njoftim fituesi, në pritje për të lidhur kontraten	Shërbim
13	Mirëmbajtje rrugë e trotuare në qytet	Ne proces zbatimi të kontratës	Shërbim
14	Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues	Realizuar kontrata	Mallra
15	Loti i Dytë "Blerje bazë materiale (Stabilizant) për mirëmbajtjen e rrugëve"	Realizuar kontrata	Mallra
16	Loti i Tretë: "Blerje bazë materiale për riparimin e urave këmbësore"	Realizuar kontrata	Mallra
17	Riparim të shtresave asfaltike dhe punime mbrojtëse të rritjes së sigurisë rrugore në NJ.A.	Në proces zbatimi të kontratës	Shërbim
18	Rikonstruksion Shkolla Jordan Misja Shkodër	Në proces zbatimi	Punë
19	Ndërtim Fushe Polisportive Shkolla Gjergj Vat Martini Njësia Administrative Velipojë	Në proces zbatimi	Punë
20	Rikonstruksion Tarrace Shkolla Muhamet Shpendi Njësia Administrative Shalë	Në proces prokurimi	Punë
21	Rikonstruksion Fasada Shkolla Seit Tagani Njësia Administrative Berdicë	Në proces prokurimi	Punë

Punime publike janë duke u kryer dhe në sektorin e bujqësisë në shërbimin e kullimit duke ndërhyrë në pastrimin e kanaleve të dyta dhe të treta në: Njësinë Administrative Dajç (në fshatrat Samrisht i Ri, Samrisht i Vjetër, Dajç dhe Pentar) në një gjatësi prej rreth 17.3 km, Njësinë Administrative Ana Malit (në fshatrat Oblikë, Obot dhe Muriqan) në një gjatësi prej rreth 9 km, Njësinë Administrative Bërdicë (në fshatrat Mali Hebaj dhe Trush) në një gjatësi prej rreth 5.5 km. Vijon puna në pastrimin e kanaleve të dyta dhe të treta në Njësinë Administrative Bërdicë (fshati Trush) dhe Njësinë Administrative Dajç (fshati Pentar).

Në shërbimin e ujitjes gjatë kësaj periudhe është ndërhyrë në veprën e marrjes së kanalit ujitës (që përfshin fshatrat Prekal dhe Ura e Shtrenjtë, të Njësisë Administrative Postribë), në shtratin e lumit Kir në sistemimin e plotë të tij.

Është në përfundim procesi i rehabilitimit të plotë të pjesës fundore të kanalit ujitës KU Postrinë me gjatësi prej 2.65 km, i cili përfshin fshatrat Rrasek, Kullaj dhe Dragoç, të Njësisë Administrative Postrinë.

Për arsye të situatës së krijuar nga COVID-19, të na mirëkuptoni në vonesën e kthimit të përgjigjes.

Duke ju uruar mbarëvajtje në punë.

KRYETAR

Voltana ADEMI

Me vendim delegimi

ZV/KRYETAR

Emilia KOLIQI